

Врз основа на член 3 став 2 од Статутот на Општина Гази Баба ("Службен гласник на Општина Гази Баба" бр.2/06), Советот на Општината Гази Баба на Четиринаесеттата седница одржана на 13.06.2006 година, донесе

Në bazë të nenit 3, paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Gazi Babës ("Buletini Zyrtar i Komunës së Gazi Babës" nr. 2/06), Këshilli i Komunës së Gazi Babës në seancën e katërbëdhjetë të mbajtur më 13.06.2006, miratoi

## **ДЕЛОВНИК НА СОВЕТОТ НА ОПШТИНАТА ГАЗИ БАБА**

## **RREGULLORE E KËSHILLIT TË KOMUNËS SË GAZI BABËS**

### **I. ОПШТИ ОДРЕДБИ**

### **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Член 1**

Со овој деловник поблиску се уредуваат определени прашања сврзани со организацијата и начинот на работа на Советот на Општината Гази Баба (во натамошниот текст: Советот), конституирањето, односно верификацијата на мандатот на членовите на Советот, правата и должностите на членовите на Советот, правата и должностите на претседателот на Советот, работата на Советот, неговите комисији, и посебните тела на Општината, програмирањето на работата на Советот, јавноста во работата на Советот и неговите комисији, актите на Советот, донесувањето прописи од надлежност на Советот, претресувањето извештаи, анализи и други материјали, давањето согласност на статути и годишни сметки, односите на Советот со Градоначалникот, односите на советот со јавните служби, установи и претпријатија, односите на Советот со советите на други општини, вршењето на стручни работи за потребите на Советот, измените на Деловникот, како и други прашања од значење за работата на Советот.

#### **Член 2**

Работата на Советот, постојаните и повремениите комисији е јавна, освен во

#### **Neni 1**

Me këtë Rregullore të Punës rregullohen më hollësisht çështje të caktuara që kanë të bëjnë me organizimin dhe mënyrën e punës së Këshillit të Komunës së Gazi Babës (në tekstin e mëtejme: Këshilli), si dhe konstituimin, përkatësisht verifikimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Këshillit, të drejtat dhe detyrat e kryetarit të Këshillit, punën e Këshillit, komisioneve të tij dhe trupave të posaçëm të Komunës, programimin e punës së Këshillit, transparencën në punën e Këshillit dhe të komisioneve të tij, aktet e Këshillit, miratimin e akteve normative nga kompetenca e Këshillit, shqyrtimin e raporteve, analizave dhe materialeve të tjera, dhënien e pëlqimit për statutet dhe llogaritë vjetore, marrëdhëniet e Këshillit me Kryetarin e Komunës, marrëdhëniet e Këshillit me shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet, marrëdhëniet e Këshillit me këshillat e komunave të tjera, kryerjen e punëve profesionale për nevojat e Këshillit, ndryshimet e Rregullores, si dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e Këshillit.

#### **Neni 2**

Puna e Këshillit, e komisioneve të përhershme dhe të përkohshme është

случаите определени со закон, Статутот на Општината Гази Баба (во натамошниот текст: Статутот) и со овој Деловник.

publike, përveç në rastet e përcaktuara me ligj, me Statutin e Komunës së Gazi Babës (në tekstin e mëtejshëm: Statuti) dhe me këtë Rregullore të Punës.

## II. КОНСТИТУИРАЊЕ НА СОВЕТОТ, ОДНОСНО ВЕРИФИКАЦИЈА НА МАНДАТОТ НА ЧЛЕНОВИТЕ НА СОВЕТОТ

## II. KONSTITUIMI I KËSHILLIT, PËRKATËSISHT VERIFIKIMI I MANDATIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT

### Член 3

Конституирањето на Советот се врши со верификација на мандатите на членовите на Советот на првата конститутивна седница на Советот.

### Neni 3

Konstituimi i Këshillit bëhet me verifikimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit në seancën e parë konstituive të Këshillit.

Советот е конституиран доколку на конститутивната седница присуствуваат и им се верификуваат мандатите на мнозинството од вкупниот број членови на Советот, по предлог на Верификационата Комисија.

Këshilli është i konstituuar nëse në seancën konstituive marrin pjesë dhe u verifikohen mandatet shumicës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, me propozim të Komisionit Verifikues.

### Член 4

Верификационата комисија ја избира Советот на почетокот на седницата од редот на новоизбраните членови на Советот.

### Neni 4

Komisionin Verifikues e zgjedh Këshilli në fillim të seancës nga radhët e anëtarëve të sapozgjedhur të Këshillit.

Верификационата комисија брои 3 члена.

Komisioni Verifikues përbëhet nga 3 anëtarë.

### Член 5

Верификационата Комисија, може да оспори решенија издадени од Општинската изборна комисија, за избор на одделни членови на Советот и да предложи верификацијата на мандатот да се одложи заради утврдување дали тие се издадени согласно постигнатите изборни резултати на учесниците.

### Neni 5

Komisioni Verifikues mund të kontestojë vendimet e lëshuara nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve për zgjedhjen e anëtarëve të veçantë të Këshillit dhe të propozojë që verifikimi i mandatit të shtyhet, me qëllim të përcaktimit nëse ato janë lëshuar në përputhje me rezultatet zgjedhore të arritura nga pjesëmarrësit.

Верификационата Комисија може да предложи одлагање на верификацијата на мандатот на одделен член на Советот, и заради тоа што:

Komisioni Verifikues mund të propozojë shtyrjen e verifikimit të mandatit të një anëtarë të veçantë të Këshillit, dhe kjo për arsye të caktuara, si:

- со сигурност не може да се утврди

- nuk mund të përcaktohet me siguri

- неговиот идентитет (исто име и презиме со други личности);
- постојат индикации за можна неспојливост на функцијата (вработен е во општинската администрација или презел функција или должност која со закон е утврдена како неспоива со функцијата член на совет);
- настапила фактичка неможност за верификација на мандатот под услови утврдени со закон (во случај на смрт, престанок на жителството во општината, правосилна пресуда за кривично дело или донесено решение за одземање на деловната способност).
- идентитети i tij/saj (ka të njëjtin emër dhe mbiemër me persona të tjerë);
- ekzistojnë indikacione për një mundësi të mospërputhjes së funksionit (është i punësuar në administratën komunale ose ka marrë një funksion ose detyrë që me ligj është përcaktuar si e pajtueshme me funksionin anëtar i këshillit);
- ka ndodhur pamundësi faktike për verifikimin e mandatit sipas kushteve të përcaktuara me ligj (në rast vdekjeje, ndërprerje të vendbanimit në komunë, vendim të formës së prerë për një vepër penale ose vendim për heqjen e aftësisë për veprim juridik).

### Член 6

Верификационата Комисија му поднесува извештај на Советот со предлог на кои членови на Советот треба да им се верификуваат мандатите, а на кои треба да се одложи верификацијата на мандатите.

Предлогот за верификација на мандатите на присутните членови на Советот се усвојува со мнозинство гласови од вкупниот број членови на Советот.

Советот со мнозинство гласови од вкупниот број членови на Советот, одлучува за секој предлог на Верификационата Комисијата, за одлагањето на верификацијата на мандатот на членови на Советот.

Доколку предлогот за одлагање на верификацијата на мандатот не го добие потребното мнозинство се смета дека Советот, го верификувал мандатот на членот на Советот, чие одлагање се барало.

### Neni 6

Komisioni Verifikues i dorëzon Këshillit një raport me propozim se cilëve anëtarë të Këshillit duhet t'u verifikohen mandatet dhe për cilët duhet të shtyhet verifikimi i mandateve.

Propozimi për verifikimin e mandateve të anëtarëve të pranishëm të Këshillit miratohet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Këshilli, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit, vendos për çdo propozim të Komisionit Verifikues për shtyrjen e verifikimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit.

Nëse propozimi për shtyrjen e verifikimit të mandatit nuk merr shumicën e nevojshme, konsiderohet se Këshilli e ka verifikuar mandatin e anëtarit të Këshillit për të cilin është kërkuar shtyrja.

Одлагањето на верификацијата на одделни мандати по предлог на Верификационата Комисијата, не може да биде подолго од 2 месеца.

Член на Советот чиј мандат е оспорен или чија верификација е одложена, има право да присуствува на седница на Советот и да учествува во работата, без право на одлучување.

#### Член 7

Верификацијата на мандатите на членовите на Советот кои не биле присутни на првата седница на Советот, на оние кои се избрани на изборите за замена, како и на оние чија верификација е одложена, ја врши Советот на првата седница на која што тие ќе присуствуваат.

### III. ПРАВА И ДОЛЖНОСТИ НА ЧЛЕНОВИТЕ НА СОВЕТОТ

#### 1. Заеднички одредби

#### Член 8

Членот на Советот ги остварува правата и должностите утврдени со законот, Статутот и со овој Деловник.

Членот на Советот се стекнува со своите права и должности по верификацијата на мандатот.

#### Член 9

Заради вршење на својата должност, членот на Советот има право од Градоначалникот, општинската администрација, јавните служби, установи и претпријатија, основани од Општината и од други институции да бара податоци што му се потребни за неговата работа во Советот.

#### Член 10

Членот на Советот не може да учествува во процесот на одлучувањето за

Shtyrja e verifikimit të mandateve të veçanta sipas propozimit të Komisionit të Verifikimit nuk mund të zgjasë më shumë se 2 muaj.

Anëtari i Këshillit, mandati i të cilit është i kontestuar ose verifikimi i të cilit është shtyrë, ka të drejtë të marrë pjesë në seancat e Këshillit dhe të kontribuojë në punë, pa të drejtë vote.

#### Neni 7

Verifikimi i mandateve të anëtarëve të Këshillit që nuk kanë qenë të pranishëm në seancën e parë të Këshillit, atyre që janë zgjedhur në zgjedhjet për zëvendësim, si dhe atyre për të cilët verifikimi është shtyrë, kryhet nga Këshilli në seancën e parë në të cilën ata do të jenë të pranishëm.

### III. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARËVE TË KËSHILLIT

#### 1. Dispozitat e përbashkëta

#### Neni 8

Anëtari i Këshillit ushtron të drejtat dhe detyrat e përcaktuara me ligj, Statut dhe me këtë Rregullore të Punës.

Anëtari i Këshillit fiton të drejtat dhe detyrat e veta pas verifikimit të mandatit.

#### Neni 9

Për ushtrimin e detyrës së vet, anëtari i Këshillit ka të drejtë nga Kryetari i Komunës, administrata komunale, shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet e themeluara nga Komuna, si dhe nga institucionet e tjera, të kërkojë të dhëna që i nevojiten për punën e vet në Këshill.

#### Neni 10

Anëtari i Këshillit nuk mund të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështje

прашања во кои тој или неговиот брачен другар, дете или роднина до втор степен странична линија има финансиски или друг личен интерес.

Членот на Советот е должен да го информира Советот за прашањата за кои тој има финансиски или друг личен интерес.

Членот на Советот не може да биде вработен во Општинската администрација на Општината во која е избран.

Со денот на вработувањето согласно со став три на овој член ќе се смета дека членот на Советот поднел оставка.

Членот на Советот вработен во јавните служби кои ги основала Општината, не може да учествува во процесот на одлучувањето за прашања што се однесуваат на јавната служба во која е вработен.

## **2. Присуствување на седници и учество во работата**

### **Член 11**

Членот на Советот има право и должност да присуствува на седниците на Советот, постојаните и повремениите комисиии во кои членува и да учествува во работата и одлучувањето.

### **Член 12**

Членот на Советот има право да присуствува и на седниците на комисиите во кои не е член, како и право да учествува во нивната работа, но без право на одлучување.

### **Член 13**

За присуството на седниците на Советот и на комисиите во кои членуваат

нè të cilat ai ose bashkëshortja e tij, fëmija ose i afërmi i tij deri në shkallën e dytë të linjës anësore ka interes financiar ose interes tjetër personal.

Anëtari i Këshillit ka detyrë t'i informojë Këshillin për çështjet për të cilat ai/ajo ka interes financiar ose interes tjetër personal.

Anëtari i Këshillit nuk mund të punojë në administratën komunale të Komunës në të cilën është zgjedhur.

Nga dita e punësimit sipas paragrafit tre të këtij neni, konsiderohet se anëtari i Këshillit ka dhënë dorëheqje.

Anëtari i Këshillit që është i punësuar në shërbimet publike të themeluara nga Komuna nuk mund të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështje që lidhen me shërbimin publik ku është i punësuar.

## **2. Prania në seanca dhe pjesëmarrja në punë**

### **Neni 11**

Anëtari i Këshillit ka të drejtë dhe detyrë të jetë i pranishëm në seancat e Këshillit, në komisionet e përhershme dhe ato të përkohshme ku bën pjesë, si dhe të marrë pjesë në punë dhe në vendimmarrje.

### **Neni 12**

Anëtari i Këshillit ka të drejtë të jetë i pranishëm edhe në seancat e komisioneve ku nuk është anëtar, si dhe të marrë pjesë në punën e tyre, por pa të drejtë në vendimmarrje.

### **Neni 13**

Për praninë në seancat e Këshillit dhe në komisionet ku marrin pjesë anëtarët e

членовите на Советот, се води евиденција.

Këshillit, mbahet evidencë e të pranishmërive.

Евиденцијата ја води општинската администрација.

Evidencën e mban administrata komunale.

#### Член 14

Општинската администрација го известуваат претседателот на Советот, за случаите кога член на Советот три пати едноподруго отсутствувал од седниците на Советот и комисиите во кои членува, а не го оправдал своето отсуство.

#### Neni 14

Administrata komunale njoftohet nga Kryetari i Këshillit për rastet kur një anëtar i Këshillit ka munguar tre herë radhazi në seancat e Këshillit dhe në komisionet ku merr pjesë, dhe nuk ka arsyetuar mungesën e tij/saj.

Претседателот на Советот е должен веднаш да ја извести Комисијата за мандатни прашања, избори и именувања, со цел да се утврдат причините за отсуството и да се утврди дали постојат законски услови за утврдување престанок на мандатот на членот на Советот или за разрешување на членот на Советот од комисиите во кои членува и да му предложи на Советот на негово место да избере друг член.

Kryetari i Këshillit është i obliguar ta njoftojë menjëherë Komisionin për Çështje Mandatare, Zgjedhje dhe Emërime, me qëllim të përcaktohen arsyet e mungesës dhe të konstatohet nëse ekzistojnë kushtet ligjore për shpalljen e përfundimit të mandatit të anëtarit të Këshillit ose për shkarkimin e anëtarit të Këshillit nga komisionet ku merr pjesë, dhe t'i propozojë Këshillit që në vend të tij/saj të zgjidhet një anëtar tjetër.

### 3. Покренување иницијативи и поднесување предлози

### 3. Ngritja e nismave dhe parashtrimi i propozimeve

#### Член 15

Членот на Советот има право на седниците на Советот:

- да ги изнесува предлозите и мислењата на граѓаните и да му предлага на Советот заземање ставови од надлежност на Советот за тие предлози и мислења;
- да дава иницијативи за донесување на прописи од надлежност на Советот, како и да поднесува амандмани на предлозите на прописите;
- да поднесува барање за давање на автентично толкување на

#### Neni 15

Anëtari i Këshillit ka të drejtë në seancat e Këshillit:

- të paraqesë propozimet dhe opinionet e qytetarëve dhe t'i propozojë Këshillit që të marrë qëndrime brenda kompetencave të vet për ato propozime dhe opinione;
- të japë iniciativa për miratimin e akteve normative brenda kompetencave të Këshillit, si dhe të dorëzojë amendamente për propozimet e akteve normative;
- të dorëzojë kërkesa për dhënien e një interpretimi autentik të akteve

- прописите;
- да иницира распишување референдум за решавање на прашања од интерес за Општината, како и за претходно изјаснување на граѓаните за одделни предлози на одлуки или за нивно потврдување;
  - да предлага претресување на прашања, појави и состојби што се од значење за определена дејност, како и од значење за граѓаните;
  - да предлага претресување на прашања што се однесуваат на спроведувањето на политиката што ја утврдил и прописите што ги донел Советот или на прашања што се однесуваат на извршување на законите и другите прописи и општи акти;
  - да предлага претресување на прашања кои се однесуваат на работата на Градоначалникот;
  - да бара од Градоначалникот да го извести Советот за својата работа;
  - да предлага претресување на прашања што се однесуваат на остварувањето на надзорот над вршењето на работите од надлежност на општината;
  - да предлага претресување на прашања во врска со состојбата во дејностите за кои Општината основала јавни служби, установи и претпријатија, како и прашања во врска со остварувањето на надзорот над нивната работа, и
  - да предлага спроведување на анкети по прашања од надлежност на Советот.
- normative;
- të nxisë shpalljen e referendumit për zgjidhjen e çështjeve me interes për Komunën, si dhe për konsultimin paraprak të qytetarëve për propozime të caktuara të vendimeve ose për konfirmimin e tyre;
  - të propozojë shqyrtimin e çështjeve, dukurive dhe gjendjeve që kanë rëndësi për një aktivitet të caktuar, si dhe për qytetarët;
  - të propozojë shqyrtimin e çështjeve që ndërlidhen me zbatimin e politikave dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli, apo çështjeve që ndërlidhen me zbatimin e ligjeve dhe aktet tjera të përgjithshme;
  - të propozojë shqyrtimin e çështjeve që ndërlidhen me punën e Kryetarit të Komunës;
  - të kërkojë nga Kryetari i Komunës që ta informojë Këshillin për punën e vet;
  - të propozojë shqyrtimin e çështjeve që ndërlidhen me ushtrimin e mbikëqyrjes mbi detyrat nën kompetencë të komunës;
  - të propozojë shqyrtimin e çështjeve që ndërlidhen me gjendjen në aktivitetet për të cilat Komuna ka themeluar shërbime publike, institucione dhe ndërmarrje, si dhe çështje që ndërlidhen me ushtrimin e mbikëqyrjes mbi punën e tyre; dhe
  - të propozojë kryerjen e anketimeve mbi çështje që janë brenda kompetencave të Këshillit.

### Член 16

Членот на Советот има право поединечно или заедно со други членови на Советот, да предлага избор и

### Neni 16

Anëtari i Këshillit ka të drejtë, veçmas ose së bashku me anëtarë të tjerë të Këshillit, të propozojë zgjedhjen dhe shkarkimin e

разрешување на претседател на Советот, претседатели и членови на комисиите и посебните тела на Општината, што ги избира односно именува Советот, на начин и под услови утврдени со закон, Статутот и овој Деловник.

#### 4. Постапување советничко прашање

##### Член 17

Членот на Советот има право на Градоначалникот и на раководните органи, односно членовите на органите на управување на јавните служби, установи и претпријатија што ги основа Општината, да им поставува 3 прашања (советнички прашања) што се однесуваат на нивната работа или на работата од нивна надлежност, односно од надлежност на органите, службите, установите и претпријатијата.

Прашањето треба да е кратко и прецизно, при што членот на советот треба да означи на кого му е упатено прашањето.

##### Член 18

Прашањето може да се поставува усно на седница на Советот, а во времето меѓу две седници писмено.

Прашањата се поставуваат и одговорите се добиваат како последна точка од дневниот ред.

Советот може да одржува и посебни седници за поставување прашања. Предлог за одржување посебна седница може да поднесат Градоначалникот, претседателот на Советот или група од 5 членови на Советот. Советот за одржување посебна седница одлучува со мнозинство гласови на присутните

Kryetarit të Këshillit, kryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve dhe organeve të veçanta të Komunës, të cilët zgjidhen ose emërohen nga Këshilli, në mënyrën dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj, Statut dhe këtë Rregullore të Punës.

#### 4. Parashtrimi i pyetjeve nga këshilltarët

##### Neni 17

Anëtari i Këshillit ka të drejtë që t'u parashtrojë Kryetarit të Komunës dhe organeve drejtuese, respektivisht anëtarëve të organeve drejtuese të shërbimeve publike, institucioneve dhe ndërmarrjeve të themeluara nga Komuna, deri në 3 pyetje (pyetje këshilltare) që lidhen me punën e tyre ose me punën që është brenda kompetencave të tyre, respektivisht brenda kompetencave të organeve, shërbimeve, institucioneve dhe ndërmarrjeve.

Pyetja duhet të jetë e shkurtër dhe e saktë, duke theksuar qartë se kujt i drejtohet pyetja.

##### Neni 18

Pyetja mund të parashtrohet me gojë në seancën e Këshillit, ndërsa gjatë kohës midis dy seancave mund të parashtrohet me shkrim.

Pyetjet parashtrohen dhe përgjigjet jepen si pika e fundit e rendit të ditës.

Këshilli mund të mbajë edhe seanca të veçanta për parashtimin e pyetjeve. Propozimin për mbajtjen e një seance të veçantë mund ta dorëzojë Kryetari i Komunës, Kryetari i Këshillit ose një grup prej 5 anëtarësh të Këshillit. Këshilli vendos për mbajtjen e seancës së veçantë me shumicë votash nga anëtarët e

членови на седницата на која е поднесен предлогот.

### Член 19

На усно поставеното прашање се одговара на седницата на која е поставено прашањето, доколку се присутни лицето на кое му е поставено или претставникот на институцијата на која тоа се однесува.

Ако на поставеното прашање не може да се даде целосен одговор на таа седница или ако се отсутни лицето на кое му е поставено или претставникот на институцијата на која тоа се однесува, одговорот во целост ќе се даде писмено или усно на наредната седница на Советот.

### Член 20

Членот на Советот може да побара на прашањето што го поставил да му се одговори писмено.

Писмениот одговор се дава во рок од 10 дена од денот на поставувањето, односно приемот на прашањето.

Ако на прашањето не може да се даде одговор во рокот од став 2 на овој член, членот на Советот ќе биде известен кога ќе му биде даден одговорот.

Ако се работи за сложено прашање, кое бара посеопфатни анализи или претпоставува следење на состојбите во подолг временски период, Советот може да определи подолг рок за давање на одговорот.

### Член 21

На прашањето поставено до Градоначалникот, одговор дава Градоначалникот или лице што тој го овластил.

pranishëm në seancën ku është dorëzuar propozimi.

### Neni 19

Për pyetjen e parashtruar me gojë jepet përgjigje në seancën ku është parashtruar pyetja, nëse është i pranishëm personi të cilit i drejtohet pyetja ose përfaqësuesi i institucionit përkatës.

Nëse për pyetjen e parashtruar nuk mund të jepet përgjigje e plotë në atë seancë, ose nëse mungon personi të cilit i drejtohet pyetja ose përfaqësuesi i institucionit përkatës, përgjigjja do të jepet në mënyrë të plotë me shkrim ose me gojë në seancën e radhës së Këshillit.

### Neni 20

Anëtari i Këshillit mund të kërkojë që pyetjes së tij/saj t'i jepet përgjigje me shkrim.

Përgjigjja me shkrim jepet brenda 10 ditëve nga dita e parashtrimit ose marrjes së pyetjes.

Nëse për pyetjen nuk mund të jepet përgjigje brenda afatit të parashikuar në paragrafi 2 të këtij neni, anëtari i Këshillit do të njoftohet se kur do të marrë përgjigjen.

Nëse bëhet fjalë për pyetje të ndërlikuar, që kërkon analiza më të gjera ose ndjekje të gjendjeve për një periudhë më të gjatë, Këshilli mund të përcaktojë një afat më të gjatë për dhënien e përgjigjes.

### Neni 21

Për pyetjen e parashtruar ndaj Kryetarit të Komunës, përgjigjen e jep Kryetari i Komunës ose personi që i njëjti e ka autorizuar.

Кога одговорот го дава лице овластено од страна на Градоначалникот, се смета дека одговорот го дал Градоначалникот.

#### Член 22

По примениот одговор, членот на Советот кој го поставил прашањето може да постави и дополнително прашање.

#### Член 23

По добиениот одговор на поставеното прашање, односно на дополнителното прашање, членот на Советот може да предложи предметот на кој се однесува неговото прашање да се стави на дневен ред на таа седница на Советот или на една од наредните седници.

За предлогот од став 1 на овој член, по ислушувањето на мислењето на Градоначалникот или лицето на кое му било поставено прашањето, одлучува Советот.

Градоначалникот или лицето на кое му е поставено прашањето, може да побара претресот по тоа прашање да се одложи додека не се соберат податоци.

Ако барањето од став 3 на овој член се усвои, Советот определува рок до кога се одлага претресувањето на тоа прашање.

#### Член 24

Доколку членот на Советот не е задоволен од добиениот одговор на прашањето, може да му предложи на Советот или на Градоначалникот на Општината, да ги разрешат раководните лица и носителите на функции, што ги смета за одговорни за состојбата од која не е задоволен.

За предлогот од ставот 1 на овој член, органите на Општината одлучуваат во

Kur përgjigjen e jep një person i autorizuar nga Kryetari i Komunës, konsiderohet se përgjigjen e ka dhënë Kryetari i Komunës.

#### Neni 22

Pas marrjes së përgjigjes, anëtari i Këshillit që ka parashtruar pyetjen mund të parashtrojë edhe një pyetje shtesë.

#### Neni 23

Pas marrjes së përgjigjes për pyetjen e parashtruar, respektivisht për pyetjen shtesë, anëtari i Këshillit mund të propozojë që çështja për të cilën lidhet pyetja e tij të vendoset në rendin e ditës të asaj seance të Këshillit ose të një prej seancave të ardhshme.

Për propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni, Këshilli vendos pasi të dëgjohet mendimi i Kryetarit të Komunës ose i personit të cilit i është drejtuar pyetja.

Kryetari i Komunës ose personi të cilit i është drejtuar pyetja mund të kërkojë shtyrjen e shqyrtimit të asaj çështjeje derisa të mblidhen të dhëna të mjaftueshme.

Nëse kërkesa nga paragrafi 3 i këtij neni miratohet, Këshilli cakton afatin deri kur shtyhet shqyrtimi i asaj çështjeje.

#### Neni 24

Nëse anëtari i Këshillit nuk është i kënaqur me përgjigjen e marrë për pyetjen, mund t'i propozojë Këshillit ose Kryetarit të Komunës të shkarkojnë personat drejtues dhe mbajtësit e funksioneve, të cilët i konsideron përgjegjës për gjendjen nga e cila nuk është i kënaqur.

Për propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni, organet e Komunës vendosin brenda

рамките на своите надлежности.

## 5. Чување тајна

### Член 25

Членот на Советот е должен да чува тајна.

Тајната може да биде државна, службена и деловна.

Како тајна се сметаат податоците што членот на Советот ќе ги дознае на седницата на Советот или комисиите, во врска со прашањата за кои на седницата се расправа без присуство на јавноста.

За тајна се сметаат и сите материјали што му се упатуваат на Советот и комисиите, а кои се означени како такви, со ознака "доверливо" од страна на подносителот на материјалите.

Со материјалите што се сметаат за тајна се постапува согласно со напомената - упатството за ракување и чување на материјалите, што се проследува кон таквите материјали.

## 6. Обезбедување на услови за вршење на функцијата член на Совет

### Член 26

Заради обезбедување на услови за вршење на функцијата член на Совет, општинската администрација и органите на управување на јавните служби, установи и претпријатија основани од Општината, на членовите на Советот:

- им укажуваат стручна помош во изработувањето на предлозите што тие му ги поднесуваат на Советот, односно комисиите, во поставувањето на советнички прашања и во вршењето на други работи што им ги доверил Советот, односно работното тело;

kompetencave të tyre.

## 5. Ruajtja e sekretit

### Neni 24

Anëtari i Këshillit detyrohet të ruajë sekretin.

Sekreti mund të jetë shtetëror, zyrtar ose afarist.

Si sekret konsiderohen të dhënat që anëtari i Këshillit merr gjatë seancave të Këshillit ose komisioneve, lidhur me çështjet që diskutohen në seancë pa praninë e publikut.

Si sekret konsiderohen gjithashtu të gjithë materialet që i drejtohen Këshillit dhe komisioneve dhe që janë të shënuara si të tilla, me shenjën "konfidenciale" nga dorëzuesi i materialeve.

Materialet që konsiderohen sekret trajtohen sipas shënimit – udhëzimit për përdorimin dhe ruajtjen e materialeve, që iu bashkangjitet materialeve të tilla.

## 6. Sigurimi i kushteve për ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit

### Neni 26

Për të siguruar kushtet për ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit, administrata komunale dhe organet drejtuese të shërbimeve publike, të institucioneve dhe ndërmarrjeve të themeluara nga Komuna, anëtarëve të Këshillit:

- u ofrojnë ndihmë profesionale në përgatitjen e propozimeve që ata ia paraqesin Këshillit ose komisioneve, në parashtrimin e pyetjeve këshilltare dhe në kryerjen e punëve të tjera që u janë ngarkuar nga Këshilli ose organi i punës;

- им обезбедуваат дополнителна документација која им е потребна за нивната работа;
- им даваат стручни објасненија и појаснувања за проблемите на кои тие работат;
- се грижат за обезбедување на технички услови за нивната работа.
- u sigurojnë dokumentacion shtesë që u nevojitet për punën e tyre;
- u japin shpjegime dhe qartësime profesionale për problemet me të cilat ata punojnë;
- kujdesen për sigurimin e kushteve teknike për punën e tyre.

### Член 27

Членовите на Советот имаат право да ги користат просториите и документацијата на Општината, за извршување на нивните права и должности.

### Neni 27

Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë të përdorin ambientet dhe dokumentacionin e Komunës për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të tyre.

## 7. Престанок и одземање на мандатот на членовите на Советот

## 7. Përfundimi dhe heqja e mandatit të anëtarëve të Këshillit

### Член 28

На член на Советот му престанува мандатот во случаите утврдени со закон.

### Neni 28

Mandati i një anëtari të Këshillit përfundon në rastet e përcaktuara me ligj.

### Член 29

Членот на Советот има право да поднесе оставка и да ја образложи.

### Neni 29

Anëtari i Këshillit ka të drejtë të japë dorëheqje dhe ta arsyetojë atë.

Оставката му се поднесува на претседателот кој ја проследува до членовите на Советот.

Dorëheqja i dorëzohet kryetarit, i cili e përcjell tek anëtarët e Këshillit.

Оставката може да се поднесе и образложи на самата седница на Советот.

Dorëheqja mund të dorëzohet dhe arsyetohet edhe gjatë vetë seancës së Këshillit.

По поднесувањето на оставката, Советот на самата седница или првата наредна седница, без расправа, констатира престанок на мандатот на членот на Советот.

Pas dorëzimit të dorëheqjes, Këshilli, në të njëjtën seancë ose në seancën e parë të ardhshme, pa debat, konstaton përfundimin e mandatit të anëtarit të Këshillit.

Претседателот на Советот ја известува општинската изборна комисија, за престанокот на мандатот на членот на Советот.

Kryetari i Këshillit e njofton Komisionin Komunal të Zgjedhjeve për përfundimin e mandatit të anëtarit të Këshillit.

### Член 30

На член на Советот му престанува

### Neni 30

Mandati i një anëtari të Këshillit përfundon

Редакциски пречистениот текст на Деловникот на Советот на Општина Гази Баба ги опфаќа - Деловник на Советот на Општина Гази Баба ("Службен гласник на Општина Гази Баба" бр.4/06) и Одлука за изменување на Деловникот на Советот на Општина Гази Баба ("Службен гласник на Општина Гази Баба" бр.12/13)

мандатот кога ќе се вработи во општинската администрација, како и кога презел функција, односно служба која, според законот, е неспоива со вршењето на функцијата член на Совет.

За настанување на случајот на неспоивост членот на Советот е должен, веднаш да го извести претседателот на Советот.

### Член 31

На членот на Советот ќе му биде одземен мандатот доколку повеќе од три пати едноподруго неоправдано отсутствувал од седниците на Советот.

### Член 32

Претседателот на Советот е должен да ја извести Комисијата за мандатни прашања, избори и именувања и да го внесе во предлогот на дневниот ред за првата наредна седница на Советот, секој случај што со себе повлекува престанок на мандатот на некој од членовите на Советот.

Комисијата за мандатни прашања, избори и именувања е должна да го разгледа секој случај што повлекува престанок или одземање на мандатот на член на Советот, да побара податоци од надлежни институции и служби за да ги потврди фактите и да ги утврди причината и денот на настанување на условите за престанок или одземање на мандатот на член на Советот.

Комисијата за мандатни прашања, избори и именувања е должна на Советот да му поднесе извештај и предлог заради констатирање престанок или донесување одлука за одземање на мандатот на член на Советот.

Советот ќе ја утврди причината и денот на престанок на мандатот иако Комисијата за мандатни прашања,

kur ai/aјo punësohet në administratën komunale, si dhe kur merr një funksion ose detyrë që, sipas ligjit, është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit.

Për rastin e papajtueshmërisë, anëtari i Këshillit ka detyrë ta njoftojë menjëherë Kryetarin e Këshillit.

### Neni 31

Mandati i një anëtari të Këshillit do t'i hiqet nëse ai/aјo ka munguar pa arsye më shumë se tri herë radhazi në seancat e Këshillit.

### Neni 32

Kryetari i Këshillit ka detyrë të njoftojë Komisionin për Çështje Mandatare, Zgjedhje dhe Emërime dhe ta përfshijë në propozimin e rendit të ditës për seancën e parë të ardhshme të Këshillit çdo rast që çon në përfundimin e mandatit të njërit prej anëtarëve të Këshillit.

Komisioni për Çështje Mandatare, Zgjedhje dhe Emërime ka detyrë të shqyrtojë çdo rast që çon në përfundimin ose heqjen e mandatit të një anëtari të Këshillit, të kërkojë të dhëna nga institucionet dhe shërbimet kompetente që të konfirmojë faktet dhe të përcaktojë arsyen dhe datën e përmbylljes së kushteve për përfundimin ose heqjen e mandatit të anëtarit të Këshillit.

Komisioni për Çështje Mandatare, Zgjedhje dhe Emërime ka detyrë t'i dorëzojë Këshillit raport dhe propozim për konstatimin e përfundimit ose për marrjen e vendimit për heqjen e mandatit të anëtarit të Këshillit.

Këshilli do të përcaktojë arsyen dhe datën e përfundimit të mandatit, edhe nëse Komisioni për Çështje Mandatare,

избори и именувања, не поднесе извештај и не даде предлог во врска со настанат случај што повлекува престанок или одземање на мандатот на член на Советот, и тоа врз основа на документи кои го потврдуваат настанувањето на услови предвидени со закон за престанок и одземање на мандатот на член на Советот, обезбедени од страна на општинската администрација.

#### IV. ПРЕТСЕДАТЕЛ НА СОВЕТОТ

##### 1. Начин на избор на претседателот на Советот

###### Член 33

Советот има претседател кој го претставува Советот и врши други работи определени со закон, Статутот на Општината и овој Деловник.

###### Член 34

Претседателот на Советот го избира Советот по предлог на еден или група членови на Советот.

Советот гласа за сите поднесени предлози, односно предложени кандидати за избор на претседател, освен за оние кандидати кои дале изјава дека не ја прифаќаат кандидатурата.

##### 2. Права и должности на претседателот на Советот

###### Член 35

Претседателот на Советот:

- ги свикува и раководи со седниците на Советот;
- се грижи за организацијата и работата на Советот;
- ги потпишува одлуките и актите на Советот и ги доставува на Градоначалникот заради објавување;

Zgjedhje dhe Emërime nuk dorëzon raport dhe nuk jep propozim lidhur me rastin që çon në përfundimin ose heqjen e mandatit të një anëtari të Këshillit, dhe kjo bëhet në bazë të dokumenteve që konfirmojnë përmeshjen e kushteve të parashikuara me ligj për përfundimin dhe heqjen e mandatit të anëtarit të Këshillit, të siguruar nga administrata komunale.

#### IV. KRYETARI I KËSHILLIT

##### 1. Mënyra e zgjedhjes së kryetarit të Këshillit

###### Neni 33

Këshilli ka kryetar, i cili e përfaqëson Këshillin dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore të Punës.

###### Neni 34

Kryetarin e Këshillit e zgjedh Këshilli në bazë të propozimit të një anëtari ose të një grupi anëtarësh të Këshillit.

Këshilli voton për të gjitha propozimet e dorëzuara, respektivisht kandidatët e propozuar për zgjedhjen e kryetarit, përveç atyre kandidatëve që kanë dhënë deklaratë se nuk e pranojnë kandidaturën.

##### 2. Të drejtat dhe detyrat e Kryetarit të Këshillit

###### Neni 35

Kryetari i Këshillit:

- thërret dhe kryeson seancat e Këshillit;
- kujdeset për organizimin dhe punën e Këshillit;
- nënshkruan vendimet dhe aktet e Këshillit dhe ia dërgon Kryetarit të Komunës për publikim;

- дава иницијатива за претресување одделни прашања од делокругот на Советот и комисиите и се грижи за усогласување на нивната работа;
  - ја поттикнува и помага меѓусебната соработка на комисиите на Советот и се грижи за нивната соработка со други органи;
  - ги закажува седниците на комисиите кога по барање на членовите на комисијата седницата нема да ја закаже претседателот на комисијата;
  - се грижи за примената на Деловникот;
  - ги толкува одредбите на Деловникот;
  - иницира и остварува соработка и координација со претседателите на советите на други општини и
  - врши и други работи определени со закон, Статутот и со овој Деловник.
- jep iniciativë për shqyrtimin e çështjeve të veçanta nga fushëveprimi i Këshillit dhe komisioneve dhe kujdeset për harmonizimin e punës së tyre;
  - nxit dhe ndihmon bashkëpunimin e ndërsjellë të komisioneve të Këshillit dhe kujdeset për bashkëpunimin e tyre me organet e tjera;
  - cakton seancat e komisioneve kur, me kërkesë të anëtarëve të komisionit, seanca nuk caktohet nga kryetari i Komisionit;
  - kujdeset për zbatimin e Rregullores;
  - interpreton dispozitat e Rregullores;
  - inicion dhe realizon bashkëpunim dhe koordinim me kryetarët e këshillave të komunave të tjera;
  - kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj, Statut dhe me këtë Rregullore.

### Член 36

Претседателот на Советот има право да учествува во работата на комисиите на Советот и да им предлага да претресуваат прашања од нивна надлежност.

### Член 37

Претседателот на Советот може заради организација на работата на Советот да формира Координативното тело кое:

- ја планира динамиката на седниците на Советот, во зависност од значењето, природата и времето на поднесување на предлозите на акти и други материјали;
- иницира дневен ред и време на одржување на седниците на Советот;
- дава иницијатива на Советот и комисиите за претресување на

### Neni 36

Kryetari i Këshillit ka të drejtë të marrë pjesë në punën e komisioneve të Këshillit dhe t'u propozojë atyre të shqyrtojnë çështje nga kompetenca e tyre.

### Neni 37

Kryetari i Këshillit, për shkak të organizimit të punës së Këshillit, mund të formojë Trup Koordinues, i cili:

- planifikon dinamikën e seancave të Këshillit, varësisht nga rëndësia, natyra dhe koha e paraqitjes së propozim-akteve dhe materialeve të tjera;
- inicion rendin e ditës dhe kohën e mbajtjes së seancave të Këshillit;
- I jep iniciativë Këshillit dhe komisioneve për shqyrtimin e

прашања од нивна надлежност.

çështjeve nga kompetenca e tyre.

Координативното тело го сочинуваат по еден член на Советот како претставник на листата за избор на членови на Советот, што согласно извештајот на Општинската изборна комисија, добила мандати на одржаните локални избори.

Trupi Koordinues përbëhet nga një anëtar i Këshillit si përfaqësues i listës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, e cila sipas raportit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve ka fituar mandate në zgjedhjet lokale të mbajtura.

### **3. Избор на претседател на Советот со јавно гласање**

### **3. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit me votim publik**

#### **Член 38**

Претседателот на Советот го избира Советот со јавно гласање, со мнозинство гласови од вкупниот број на членовите на Советот.

#### **Neni 38**

Kryetarin e Këshillit e zgjedh Këshilli me votim publik, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

#### **Член 39**

Ако се предложени повеќе кандидати за претседател на Советот, избран е кандидатот кој добил мнозинство гласови од вкупниот број на членовите на Советот.

#### **Neni 39**

Nëse janë propozuar më shumë kandidatë për Kryetar të Këshillit, i zgjedhur konsiderohet kandidati që ka marrë shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

#### **Член 40**

Советот гласа одделно за секој од предложените кандидати.

#### **Neni 40**

Këshilli voton veçmas për secilin nga kandidatët e propozuar.

#### **Член 41**

Претседателот на Советот ги повикува членовите на Советот да се изјаснуваат "за" предлогот, без повикување да се изјаснат "против", односно "воздржан".

#### **Neni 41**

Kryetari i Këshillit i thërret anëtarët e Këshillit të deklarohen „për“ propozimin, pa i thirrur të deklarohen „kundër“ ose „të abstenojnë“.

Членот на Советот во постапката за избор на претседател на Советот со јавно гласање има право да се определи, односно да гласа "за" само за еден од кандидатите.

Anëtari i Këshillit në procedurën e zgjedhjes së Kryetarit të Këshillit me votim publik ka të drejtë të vendosë, respektivisht të votojë „për“ vetëm për një nga kandidatët.

#### **Член 42**

Доколку во првиот круг никој од кандидатите за претседател на советот не го добил потребното мнозинство гласови, се пристапува кон втор круг на гласање за двајцата кандидати кои во

#### **Neni 42**

Nëse në raundin e parë asnjë nga kandidatët për Kryetar të Këshillit nuk ka marrë shumicën e nevojshme të votave, kalon në raundin e dytë të votimit për dy kandidatët që në raundin e parë kanë

првиот круг добиле најголем број гласови. marrë numrin më të madh të votave.

#### Член 43

Ако во првиот круг повеќе кандидати добиле ист број на гласови, заради што не може да се определат двајца кандидати што имаат најголем број на гласови, гласањето се повторува само за кандидатите што имаат ист број на гласови, со цел да се определат двајцата кандидати за кои ќе се гласа во вториот круг.

#### Член 44

Ако и по вториот круг ниту еден од двајцата кандидати не го добил потребниот број гласови тогаш се повторува постапката за избор на претседател на Советот.

#### 4. Избор на претседател на Советот со тајно гласање

#### Член 45

Изборот на претседател на Советот може да се изврши со тајно гласање, доколку за таков предлог на член на Советот одлучи Советот со мнозинство гласови од вкупниот број членови на Советот.

#### Член 46

Со тајното гласање раководи комисија што ја избира Советот по предлог на членот на Советот, што предложил гласањето да биде тајно.

#### Член 47

Тајно гласање за избор на претседател на Советот се врши со гласачки ливчиња.

На гласачкото ливче за избор на претседател на Советот се отпечатуваат имињата и презимињата на лицата предложени за избор, односно разрешување и тоа според редот на

#### Neni 43

Nëse në raundin e parë më shumë kandidatë kanë marrë të njëjtin numër votash, për çka nuk mund të përcaktohen dy kandidatët me numrin më të madh të votave, votimi përsëritet vetëm për kandidatët që kanë të njëjtin numër votash, me qëllim që të përcaktohen dy kandidatët për të cilët do të votohet në raundin e dytë.

#### Neni 44

Nëse edhe pas raundit të dytë asnjëri nga dy kandidatët nuk ka marrë numrin e nevojshëm të votave, atëherë procedura e zgjedhjes së Kryetarit të Këshillit përsëritet.

#### 4. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit me votim të fshehtë

#### Neni 45

Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit mund të kryhet me votim të fshehtë, nëse për një propozim të tillë të një anëtarit të Këshillit vendos Këshilli me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

#### Neni 46

Për votimin e fshehtë udhëheq një komision që zgjidhet nga Këshilli sipas propozimit të anëtarit të Këshillit që ka propozuar që votimi të jetë i fshehtë.

#### Neni 47

Votimi i fshehtë për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit kryhet me fletëvotime.

Në fletëvotimin për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit shtypen emrat dhe mbiemrat e personave të propozuar për zgjedhje ose shkarkim, sipas radhës së propozimeve të paraqitura.

поднесените предлози.

На гласачкото ливче пред името на кандидатите се става реден број.

#### **Член 48**

Гласачките ливчиња мораат да бидат со еднаква големина, боја и форма.

На секое гласачко ливче се става печат на Општината.

#### **Член 49**

Секој член на Советот добива по едно гласачко ливче.

Откако ќе се утврди дека сите членови на Советот, добиле по едно гласачко ливче, претседавачот ќе ги даде потребните објаснувања за начинот на гласањето и ќе го определи времето потребно за пополнување на гласачките ливчиња.

#### **Член 50**

Членот на Советот гласа на тој начин што го заокружува редниот број пред името и презимето на кандидатот за кого гласа и лично го спушта гласачкото ливче во поставената гласачка кутија, превиткано на начин што обезбедува тајност на гласањето.

#### **Член 51**

Откако сите присутни членови на Советот ќе гласаат и откако претседавачот ќе објави дека гласањето е завршено, се преминува на утврдување на резултатите од гласањето.

Резултатите од гласањето се утврдуваат врз основа на предадените гласачки ливчиња.

#### **Член 52**

Гласачкото ливче од кое не може јасно да се утврди за кого е гласано (заокружени се повеќе кандидати,

Para emrit të kandidatëve në fletëvotim vendoset një numër rendor.

#### **Neni 48**

Fletëvotimet duhet të jenë me të njëjtën madhësi, ngjyrë dhe formë.

Në çdo fletëvotim vendoset vula e Komunës.

#### **Neni 49**

Secili anëtar i Këshillit merr nga një fletëvotim.

Pasi të konfirmohet se të gjithë anëtarët e Këshillit kanë marrë nga një fletëvotim, kryetari i seancës do të japë shpjegimet e nevojshme për mënyrën e votimit dhe do të caktojë kohën e nevojshme për plotësimin e fletëvotimeve.

#### **Neni 50**

Anëtari i Këshillit voton në atë mënyrë që rrethon numrin rendor para emrit dhe mbiemrit të kandidatit për të cilin voton dhe vetë vendos fletëvotimin në kutinë e vendosur të votimit, i palosur në një mënyrë që siguron fshehtësinë e votimit.

#### **Neni 51**

Pasi të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit të kenë votuar dhe kryetari i seancës të shpallë përfundimin e votimit, kalohet te përcaktimi i rezultateve të votimit.

Rezultatet e votimit përcaktohen në bazë zuar të fletëvotimeve të dorëzuara.

#### **Neni 52**

Fletëvotimi nga i cili nuk mund të përcaktohet qartë për kë është votuar (janë rrethuar më shumë kandidatë, janë

